



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH.nr. 291/19**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Goran Milenković– Kryetar, z.Nuhi Paçarizi- Referues, z.Blerim Dina- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Berisha Company” Sh.a –Ferizaj kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku për kontratë është rekomanduar OE “Eurotrans” shpk-Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “Asfaltimi i rrugës Çamëria Bajnic-Rakaj” me numër të prokurimit : 652-19-2109-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Kaçanik më datën 04.07.2019 mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Berisha Company” Sh.a lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Asfaltimi i rrugës Çamëria Bajnic-Rakaj” me numër të prokurimit : 652-19-2109-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK- Kuvendi Komunal Kaçanik.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Asfaltimi i rrugës Çamëria Bajnic-Rakaj” me numër të prokurimit : 652-19-2109-5-2-1 AK- Kuvendi Komunal Kaçanik dhe lënda kthehet në **Ri vlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues“Berisha Company”Sh.aaprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:12.04.2019

Hapja e ofertave është bërë me dt:07.05.2019

Data e njoftimit me letër standarde për tenderuesit e eliminuar: 20.05.2019

Data e vendimit të AK-së për dhënie të kontratës: 20.05.2019

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik“Berisha Company”Sh.ame dt: 24.05.2019, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues- “Kuvendi Komunal Kaçanik” me datën 30.05.2019ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE:“Berisha Company”Sh.asi të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “Berisha Company”Sh.asi palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me07.06.2019me nr. 291/19,kundër njoftimit për dhënie të kontratës,ku për kontratë është rekomanduar OE-“Eurotrans”shpk-Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull“Asfaltimi i rrugës Çamëria Bajnic-Rakaj” me numër të prokurimit : 652-19-2109-5-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “Kuvendi Komunal Kaçanik” duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 60,69të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 10.06.2019ka autorizuar ekspertin shqyrtuesprofesional tëprokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtuesprofesional në raportin e dt:20.06.2019,lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues



“Berisha Company” Sh.a në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë posedon listën me 15 të punësuar por nuk dëshmohet me kontratë ashtu siç është kërkuar nga AK

1. Inxhinierit të diplomuar të Ndërtimtarisë konstruktiv i mungon dëshmia mbi përvojën e punës
2. Inxhinierit të diplomuar të Ndërtimtarisë-hidros i mungon dëshmia mbi përvojën e punës
3. Gjeodetit të licencuar ( bacheior ose master )-i mungon CV dhe dëshmia mbi përvojën e punës

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dëshmitë në lëndës dhe kërkesat e AK-së konstaton se kërkesat e AK – së në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë janë:

- Kontratat ose marrëveshjet me stafin e kërkuar, e po ashtu për te njëjtin stafin profesional kërkojnë kopjet e diplomave dhe një CV
- Dëshmia se paku 5 vite përvoja e punës
- Inxhinieri i diplomuar i ndërtimtarisë konstruktiv Sedat Ahmeti ka të bashkangjitur CV ,kontratën ku ka filluar punën prej dt.10.01.2016 që nuk ka 5 vite të plota përvoja pune dhe i mungon dëshmia (referencë, vërtetim) e përvojës së punës, ku në listën e stafit të dorëzua figuron 15 vite përvojë pune.
- Inxhinieri i diplomuar i Ndërtimtarisë-hidros Mexhid Zylfiu ka të bashkangjitur CV, kontratën e punës ku ka filluar nga dt.05.04.2017 nuk i ka 5 vite të plota përvoja pune dhe i mungon dëshmia (referencë, vërtetim) e përvojës së punës ku në listën e stafit figuron 10 vite përvojë pune.
- Gjeodeti i licencuar ( bacheior ose master ) ka të bashkangjitur kontratën ku ka filluar punën prej dt.01.02.2017 që nuk ka 5 vite të plota përvoja pune dhe i mungon dëshmia (referencë, vërtetim) e përvojës së punës ku në listën e stafit figuron 20 vite përvojë pune, gjithashtu i mungon edhe CV.

**Sqarim :** Meqenëse OE “Eurotrans” SH.P.K ka të bashkangjitur në ofertë e tij listën e stafit ku inxhinieret në fjalë janë në këtë listë, po ashtu në këtë listë dhe në CV e dorëzuara e përmbushin kërkesën e AK (përvojën e punës). AK është dashur të kërkojë informacion sqarues nga OE i rekomanduar për kontratë duke u bazuar në nenin 72 të LPP-së dhe në sqarimet në RRUOPP-në neni 39.8 ku thotë: *CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar mund të kërkojë informacion shtesë,*

Po ashtu neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë paragrafi 1 dhe 3 i LPP-së ku thotë:

*72.1 Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.*

*72.3 Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.*

Prandaj duke u bazuar në sqarime më lartë ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues **është i bazuar**.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtuesi propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin nr.1), të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet **në rivlerësim**.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 21.06.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues sepajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 25.06.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 04.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seance përfaqësuesi i OE-së ankues z. Bajrami i cili deklaroj: Siç shihet edhe në shkresat që i ka OSHP pas njoftimit të Autoritetit Kontraktues për shpalljen të fituesit në lidhje me tenderin e lartcekur në kemi kërkuar qasje në dokumentet zyrtare dhe pasi kemi kontrolluar kemi pas qasje kemi konstatuar se “Euro Trans” SH.P.K. – Doganaj e cila është shpallur fitues i mungon dokumentacioni sipas kërkesave në piken 9.1 dhe 9.2 aty kërkohet që kompania të ketë së paku 15 punëtorë dhe të dëshmojë me



kontrata, OE Fitues e ka paraqitur listën e punëtorëve por iu mungojnë kontratat apo marrëveshjet. Pika 2. Inxhinieri i Diplomuar i inxhinierisë konstruktive apo infrastrukturës kërkohet me përvojë pune 5 vjeçare pas diplomimit, Inxhinierin që e ka paraqitur në listë i mungon CV-ja e punës apo referenca që dëshmon përvojën e punës. Kërkohet edhe Inxhinier i Hidros për të cilin po ashtu mungoj ndeshmi mbi përvojën e punës. Njëjtë vlen edhe për Gjeodetin e Licencuar. Siç thashë edhe më lartë sa i përket stafit të paraqitur nga kompania duke përfshirë edhe stafin kryesor që do të involvohet në projekt kompania ka dështuar të dëshmojë se e plotëson këtë kriter sipas kërkesave të Autoriteti Kontraktues përkundër kësaj Autoriteti Kontraktues e ka shpallur Fitues, dhe nëse OE "Berisha Company" SH.A. kemi bërë një kërkesë për rishqyrtim të vendimit të cilin Autoriteti Kontraktues e ka hedh poshtë si të pa baze, andaj ne jemi detyruar që të drejtohem OSHP-së. Ne kemi pranuar ekspertizën e ekspertës për këtë lëndë edhe në konfirmimin me e-mail e kemi pranuar të gjeturat e ekspertës shqyrtuese dhe tani pajtohem me mendimin e Ekspertes Shqyrtuese.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Kogja deklaroi: Pajtohem me mendimin e ekspertës shqyrtuese që lënda të kthehet në rivlerësim dhe të aplikohet neni 72 i LPP-së

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroi: Kërkojmë të kthehet lënda në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroi: Kërkojmë që ankesa jone të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, në vijim jep konstatime lidhur me pretendimet e OE "Berisha Company" Sh.a.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë posedon listën me 15 të punësuar por nuk dëshmohet me kontratë ashtu siç është kërkuar nga AK.

1. Inxhinierit të diplomuar të Ndërtimtarisë konstruktiv i mungon dëshmia mbi përvojën e punës;
2. Inxhinierit të diplomuar të Ndërtimtarisë-hidros i mungon dëshmia mbi përvojën e punës
3. Gjeodetit të licencuar ( bacheior ose master )-i mungon CV dhe dëshmia mbi përvojën e punës;



Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional duke u bazuar në dëshmitë në lëndës dhe kërkesat e AK-së konstaton se kërkesat e AK –së në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë janë:

- Kontratat ose marrëveshjet me stafin e kërkuar, e po ashtu për te njëjtin stafin profesional kërkojnë kopjet e diplomave dhe një CV
- Dëshmia se paku 5 vite përvoja e punës
- Inxhinieri i diplomuar i ndërtimtari konstruktiv Sedat Ahmeti ka të bashkangjitur CV ,kontratën ku ka filluar punën prej dt.10.01.2016 qe nuk ka 5 vite të plota përvoja pune dhe i mungon dëshmia (referencë, vërtetim) e përvojës së punës, ku në listën e stafit të dorëzua figuron 15 vite përvojë pune.
- Inxhinieri i diplomuar i Ndërtimtarisë-hidro Mexhid Zylfiu ka të bashkangjitur CV, kontratën e punës ku ka filluar nga dt. 05.04.2017 nuk i ka 5 vite të plota përvoja pune dhe i mungon dëshmia (referencë, vërtetim) e përvojës së punës ku në listën e stafit figuron 10 vite përvojë pune.
- Gjeodeti i licencuar ( bacheior ose master ) ka të bashkangjitur kontratën ku ka filluar punën prej dt.01.02.2017 qe nuk ka 5 vite të plota përvoja pune dhe i mungon dëshmia (referencë, vërtetim) e përvojës së punës ku në listën e stafit figuron 20 vite përvojë pune, gjithashtu i mungon edhe CV.

Sqarim : Meqenëse OE “Eurotrans” SH.P.K ka të bashkangjitur në ofertë e tij listën e stafit ku inxhinieret në fjalë janë në këtë listë, po ashtu në këtë listë dhe në CV e dorëzuara e përmbushin kërkesën e AK( përvojën e punës). AK është dashur të kërkojë informacion sqarues nga OE i rekomanduar për kontratë duke u bazuar në nenin 72 të LPP-së dhe në sqarimet në RRUOPP-në neni 39.8 ku thotë: CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar mund të kërkojë informacion shtesë,

Po ashtu neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë paragrafi 1 dhe 3 i LPP-së ku thotë:

72.1 Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

72.3 Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Prandaj duke u bazuar në sqarime më lartë, Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59,72 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK –Kuvendi Komunal Kaçanik

1x1 OE- “Berisha Company”Sh.a

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.